

VENDIM
Nr.605, datë 27.4.2009

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.432, DATË 13.7.2007 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR KLASIFIKIMIN E FUNKSIONEVE, TRAJTIMIN ME PAGË DHE
SHTESA MBI PAGË PËR PUNONJËSIT NË SHËRBIMIN INFORMATIV TË
SHTETIT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 8 e 22 të ligjit nr.9357, datë 17.3.2005 “Për satutin e punonjësit të Shërbimit Informativ të Shtetit”, të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.10025, datë 27.11.2008 “Për buxhetin e vitit 2009”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave,

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.432, datë 13.7.2007 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

a) Lidhja nr.1 “Klasifikimi i funksioneve në Shërbimin Informativ të Shtetit”, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe emërtim, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

b) Lidhja nr.2 “Struktura dhe nivelet e pagave, sipas klasifikimit të funksioneve, për punonjësit në Shërbimin Informativ të Shtetit”, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe emërtim, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet buxhetore të vitit 2009, planifikuar për rritjen e pagave.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 maj.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja nr.1

KLASIFIKIMI I FUNKSIONEVE NË SHËRBIMIN INFORMATIV TË SHTETIT

Funksionet në shërbimin Informativ të Shtetit, klasifikohen në 4 nivele:

- I. Punonjës mbështetës;
- II. Punonjës të nivelit zbatues;
- III. Punonjës të nivelit të mesëm drejtues;
- IV. Punonjës të nivelit të lartë drejtues.

Niveli I: Merret me zbatimin e detyrave në këtë nivel, duke u bazuar në eksperiencën profesionale të fushës, dhe në njohuritë e specialitetit.

- | | |
|---------------------------------------|-----------------|
| a) Ndihmës inspektor. | Klasa I.1 – I.4 |
| b) Inspektor në drejtoritë e bazës. | Klasa I.5 |
| c) Inspektor në drejtorinë e Tiranës. | Klasa I.6 |

Niveli II: Ka përgjegjësinë për punën konkrete, sipas drejtimeve të miratuara, bën të mundur koordinimin e mendimit dhe opsioneve të reja në një fushë të caktuar, përgatitjen e materialeve përfundimtare, të cilat duhen aprovuar nga niveli menaxhues, sipas hierarkisë administrative.

a) Inspektor në Aparatin Qendror; Klasa II.1
Kryetar dege në drejtoritë e bazës;
Përgjegjës seksioni në Drejtorinë e Tiranës.

b) Kryetar dege në Drejtorinë e Tiranës; Klasa II.2
Përgjegjës sektori/Grupi në Aparatin Qendror;
Zëvendësdrejtor dhe Kryetar dege në drejtoritë e bazës;
Inspektor në Aparatin Qendror.

c) Zëvendëskryetar dege në Aparatin Qendror; Klasa II.3
Punonjës i teknologjisë së Informacionit në Aparatin Qendror;
Shef baze/turni në Aparatin Qendror;
Inspektor në Aparatin Qendror.

Niveli III: Ka përgjegjësinë e programimit të punëve, menaxhimit dhe zbatimit të tyre, për drejtimet që mbulon, në përputhje me prioritetet e Shërbimit Informativ të Shtetit, të cilat duhen miratuar dhe aprovuar nga niveli menaxhues më i lartë i njësisë strukturore sipas drejtimeve përkatëse.

a) Kryetar dege në Aparatin Qendror; Klasa III.1
b) Drejtor drejtorie në drejtoritë e bazës; Klasa III.2
Zëvendësdrejtor drejtorie në Aparatin Qendror;
Zëvendësdrejtor dhe Kryetar dege në Drejtorinë e Tiranës;
Kryetar dege dhe përgjegjës i njësive funksionale.

Niveli IV: Ka përgjegjësi për menaxhimin e punës në Shërbimin Informativ të Shtetit, përcaktimin e strategjisë dhe hartimin e politikave të përgjithshme në fushat që mbulon njësia e tij strukturore, përdorimin me efikasitet të të gjitha burimeve financiare, njerëzore etj., me qëllim arritjen e rezultateve të përcaktuara, si dhe dhënien e produktit përfundimtar, Drejtorit apo zv/Drejtorit të Shërbimit Informativ të Shtetit.

a) Këshilltar; Klasa IV.1
Drejtor drejtorie në Aparatin Qendror;
Drejtor drejtorie në Drejtorinë e Tiranës;
Zëvendësdrejtor departamenti.

b) Shef kabineti Klasa IV.2
Drejtor Departamenti.

**STRUKTURA DHE NIVELET E PAGAVE SIPAS KLASIFIKIMIT TË FUNKSIONEVE, PËR
PUNONJËSIT NË SHËRBIMIN INFORMATIV TË SHTETIT**

Nivelet e klasifikimit	Klasifikimi i punonjësve sipas niveleve	Klasa për çdo nivel klasifikimi	Paga bazë mujore për klasë në lekë	Shtesa për vjetërsi në %	Shtesa për gradë në %
1	2	3	4	5	6
I	Punonjës mbështetës	I.1	18000	1%	2%
		I.2	21000	1%	2%
		I.3	24500	1%	3%
		I.4	27500	1%	5%
		I.5	36000	1%	6%
		I.6	37000	1%	6%
II	Punonjës të nivelit zbatues	II.1	41000	1%	8%
		II.2	44000	1%	12%
		II.3	46000	1%	12%
III	Punonjës të nivelit të mesëm drejtues	III.1	49000	1%	14%
		III.2	51000	1%	16%
IV	Punonjës të nivelit të lartë drejtues	IV.1	55000	1%	20%
		IV.2	63000	1%	20%
Jashtë klasifikimit	Inspektor i Përgjithshëm në Sh.I.Sh.		124000	0%	0%